



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALLAKASTËR
KËSHILLI I BASHKISË

Nr. 2590 / Regj. 13

Ballsh më, 22 . 08 . 2021

VENDIM

Nr. 40 Datë 22 / 09 / 2021

PËR

**RIORGANIZIMIN E ADMINISTRATAVE TË NJËSIVE ADMINISTRATIVE TË
BASHKISË MALLAKASTËR**

Në zbatim të nenit 8, pika 2, neni 9, pika 1.1, gërma b, neni 95, pika 1 të ligjit 139/2015 "Për vetëqeverisjen Vendore", i ndryshuar, Ligjit nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale të njësive të qeverisjes vendore në Republikën e Shqipërisë", Neni 3, pika 2 të Ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë"

VENDOSI

1. Riorganizimin e administratës së Njësive Administrative të Bashkisë Mallakastër.
2. **Administrata e Bashkisë Mallakastër**, me adresë lagjia 18 Prilli, Godina e Bashkisë Mallakastër do të mbuloj shërbimet administrative të Njësive të poshtëshënuara:
 - *Njësia Administrative Ballsh*
 - *Njësia Administrative Ngraçan*
 - *Njësia Administrative Aranitas*
 - *Njësia Administrative Qendër*
 - *Njësia Administrative Greshicë*
 - *Njësia Administrative Hekal*
3. **Administrata e Njësive Administrative Fratar**, me adresë fshati Damës, Mallakastër do të mbuloj shërbimet administrative të Njësive të poshtëshënuara:
 - *Njësia Administrative Fratar*
 - *Njësia Administrative Kutë*
 - *Njësia Administrative Selitë*
4. Ky vendim shoqërohet me relacion shpjegues.
5. Ky vendim hynë në fuqi pas 10 ditësh nga shpallja e tij.

KRYETAR

Mbarime Isufaj

